



Çfarë është sinjalizimi?

Sinjalizimi është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit të njësisë përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.

Cilat janë aktet ligjore që mbrojnë sinjalizuesin, kur ndaj tij merren masa hakmarrëse?

- Ligj Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe Mbrojtjen e sinjalizuesve” i përditësuar
- Urdhër nr. 1222, datë 11.07.2017 i ILDKPKI
- Rregullore për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja në ILDKPKI



Funded by the European Union



INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TE PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE INTERESAVE



Ku mund të drejtohem për të sinjalizuar?

“Sinjalizim i brendshëm” kryhet nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të organizatës.

“Sinjalizim i jashtëm” është raportimi i kryer nga sinjalizuesi pranë ILDKPKI-së.

“Sinjalizim publik” është njoftimi publik apo raportimi me mjete të komunikimit publik apo vende publike.

Për më tepër informacion kontaktoni në:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Website: <https://ahc.org.al/>

Tel: (0)42233671 0694075732 0682023699

ILDKPKI

Website: <https://www.ildkpkj.al/>

Tel: 0800 9999



Të sinjalizosh nuk do të thotë të Spiunosh!

Informohu!

Kontribuo!

Lufta kundër korrupsionit

FILLON NGA TY

Kush mund të sinjalizojë?

Çdo person, i cili vihet në dijeni për veprime ose praktika të dyshuara të korrupsionit, gjatë punës ose në lidhje me veprimtarinë e tij të punës pranë organizatës.

“Kjo fletëpalosje është prodhuar në kuadër të zbatimit të projektit “Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj fletëpalosje është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Qendrës ALTRI dhe Friends of Europe dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikpamjet e Bashkimit Evropian.”



Procedurat që ndiqen në rast mbrojtje nga hakmarrja?



Paraqitja e kërkesës për mbrojtje pranë Njesisë Përgjegjëse/ILDKPKI.



Hetimi i pretendimeve për hakmarrje dhe vlerësimin të shkaqeve të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur.



Njoftimi me shkrim i sinjalizuesit për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit që do ndjekë çështjen.



Përfundimi i procedurës hetimore, jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.



Marrja e vendimit (mosfillim i hetimit administrativ/ përfundim i hetimit administrativ/ konstatim i ekzistencës së hakmarrjes)



Urdhërimi i autoritetit publik/ privat mbi marrjen e masave për riparimin e shkeljes së kryer.

Çfarë duhet të përmbajë sinjalizimi?

- a) identitetin dhe kontaktin tënd si sinjalizues
- c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse.
- ç) referimin në Kodin Penal të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;
- d) në rastin e sinjalizimit të jashtëm, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

Ti sinjalizon edhe ANONIM!



Sinjalizimi mbetet anonim nëse janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara.

Nëse organi kompetent ose subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, çdo person i interesuar ose ILDKPKI-ja ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës. Sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë sipas Kodit Civil, shpërblimin për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes.

Ndaj cilave masa hakmarrëse ju mbron ligji?

- a) shkarkimit nga puna;
- b) pezullimit nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- c) transferimit brenda ose jashtë organizatës;
- ç) uljes në detyrë;
- d) uljes së pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- e) humbjes së statusit dhe të privilegjeve;
- f) mosngritjes në detyrë;
- g) heqjes së të drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- h) vlerësimeve negative në marrëdhënien e punës;
- i) formave të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

- Identiteti i sinjalizuesit i bëhet i ditur personave të tretë, vetëm me pëlqimin e tij me shkrim. Shkelja e garancisë për konfidencialitet ndëshkohet me gjobë nga 150.000 - 300.000 lekë.
- ILDKPKI, Njësia përgjegjëse ose çdo person që merr informacion konfidencial nga njësiti përgjegjëse ose ILDKPKI, ka detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të sinjalizuesit. Ky detyrim mbaron në momentin që sinjalizuesi jep miratim me shkrim për zbulimin e identitetit të tij ose në rast se sinjalizimi bëhet publik nga vetë personi.